

PROCESVERBAL 21/2024

I mbajtur me rastin e takimit të 6 (gjashtë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitetet, mbajtur me datë 21.06.2024 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e bonus banimit;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-181-30362;**
- 4. Të ndryshme;**

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Denis Sofra - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e bonus banimit;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që Kuvendi edhe vitin e kaluar ka miratuar një vendim të tillë për bonus banim dhe atë me 50% e shumës së qerasë minimale të banesave në tregun e lirë në territorin e Komunës së Suharekës ku përfitues kanë qenë 10 familje. Tani kemi të bëjmë me shumën e njejtë të pagesës 50% por numri i përfituesve të familjeve do të jetë 12.

Denis Sofra - hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2.

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-181-30362;

Avni Bytyqi - me datë 31 maj 2024 Kryetari i Komunës Bali Muharremaj ka pranuar një kërkesë nga Arben Bytyqi, nga fshati Nishor e cila në kërkesë e përshkruan se me datë 26.05.2024 i ka ndodhur një fatkeqësi natyrore nga rrufeja, ku iu ka goditur shtëpia dhe nga goditja e rrufesë kulmi i shtëpisë iu ka djegur tërësisht si dhe pllaka dhe muret kanë pësuar krisje si pasojë e temperaturës nga zjarri. Kërkesa është aprovuar nga ekzekutivi dhe mjetet në shumën prej 5.000€ janë siguruar nga kategoria ekonomike e subvencioneve nga dy kode të dy drejtorive. Ky vendim e ka marrë aprovimin në KPF për ta dërguar në Kuvend.

Denis Sofra - hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3

Aprovohet pika 3

Pika 4. Të ndryshme;

Denis Sofra - hap debatin. Nuk ka debat.

Takimi përfundoi: 09:10

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj